



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Veçantë

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202200532/15

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2023

**Lënda:** *Rekomandim për mbajtjen e procesverbalit të marrjes në dorëzim dhe të dorëzimit të sendeve personale të të burgosurit në rastet e transferimit të tij nga një IEVP në tjetrën.*

**DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BURGJEVE**

Tiranë

**IEVP MALËSI E MADHE**

**IEVP DURRËS**

*Të nderuar,*

Në Institucionin e Avokatit të Popullit janë paraqitur ankesa nga dy të burgosur në IEVP të ndryshme, në të cilat ndërmjet të tjerave është ngritur shqetësimi se pas transferimit nga një institucion në një tjetër nuk u janë dorëzuar sendet e tyre personale.

Më konkretisht, në Dhjetor të vitit 2021 është regjistruar ankesa e të dënuarit A. V., i cili pretendon se i janë vjedhur disa sende personale në IEVP Fier kur është

transferuar nga ky institucion për në I EVP Malësi e Madhe<sup>1</sup> dhe se disa sende që atij i lejoheshin t'i mbante më parë në I EVP Fier i janë ndaluar t'i mbajë në I EVP Malësi e Madhe.

Në muajin Prill të vitit 2022 është regjistruar ankesa e familjarit të të burgosurit A. L., i cili pretendon se disa sende personale që ai mbante në I EVP Durrës nuk janë transferuar bashkë me të në I EVP Malësi e Madhe<sup>2</sup>.

Për verifikimin e këtyre ankesave kemi kërkuar pranë I EVP Fier, I EVP Malësi e Madhe, I EVP Durrës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve të na vihet në dispozicion informacion mbi pretendimet e të burgosurve, si dhe dokumentacioni përkatës. Më konkretisht kemi kërkuar të na dërgohet fotokopje e procesverbaleve të marrjes në dorëzim të sendeve personale të të dy të dënuarve nga stafi që i ka transportuar ato dhe procesverbaleve të dorëzimit të sendeve pas transferimit të të dënuarve në I EVP-të përkatëse.

Mbajtja e procesverbalit të marrjes në dorëzim dhe të dorëzimit të sendeve personale të të burgosurit që transferohet është kërkesë ligjore sipas neneve 25 dhe 108, pika 6 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve<sup>3</sup>. Për më tepër në nenin 25 të Rregullores përcaktohet se:

Neni 25:

*“1. Të burgosurit i lejohet të mbajë veshje, sende të përdorimit personal ose objekte, që kanë një vlerë të veçantë morale ose personale.*

*2. Pas hartimit të procesverbalit të pranimit të të burgosurit, me dokumentet shoqëruese dhe sendet e tij personale, personeli përkatës organizon kontrollin e imtësishëm fizik dhe të materialeve personale të të burgosurit dhe në rast se konstaton sende që nuk lejohen të mbahen në institucion, sipas dispozitave të kësaj*

---

<sup>1</sup> Referuar Urdhrit të transferimit Nr.11769/1 Prot., datë 04.11.2021, ky i dënuar bashkë me tre të burgosur të tjerë, është transferuar bazuar në email-in e datës 01.11.2021 të Drejtorit të I EVP Fier për arsye të pamundësisë së akomodimit.

<sup>2</sup> I dënuari A. L. është transferuar nga I EVP Durrës në I EVP Malësi e Madhe me Urdhrit Nr.4387/1 Prot., datë 13.04.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

<sup>3</sup> Miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 209, datë 6.4.2022.

*rregulloreje, i regjistron ato në librin përkatës dhe harton një procesverbal. Procesverbali nënshkruhet nga i burgosuri dhe punonjësi përgjegjës i institucionit, në prani të një punonjësi tjetër, ku një kopje e procesverbalit i jepet të burgosurit dhe kopja tjetër administrohet në arkivin e institucionit.*

*3. Sendet personale dhe vlerat monetare të të burgosurit i kthehen atij në momentin e lirimit ose mund të tërhiqen në çdo kohë nga anëtarët e familjes ose nga persona të ndryshëm nga anëtarët e familjes, sipas autorizimit të lëshuar nga i burgosuri, kundrejt procesverbalit të firmosur nga marrësi dhe nëpunësi i institucionit. Sendet që nuk mund të ruhen për shkak të cilësive, u dërgohen personave të autorizuar nga i burgosuri me shpenzimet e veta.*

*4. I burgosuri transferohet së bashku me sendet vetjake”.*

Ndërsa, në nenin 108, pika 6, përcaktohet se:

*“Në çdo rast të kryerjes së transferimeve të të burgosurit, personeli i policisë harton dhe administron procesverbalet e marrjes në dorëzim dhe të dorëzimit të të burgosurit dhe të sendeve të tij personale”.*

Detyrimi ligjor i punonjësve të policisë për mbajtjen e procesverbalit të marrjes në dorëzim të sendeve personale evidentohet edhe në Urdhrin Nr.651, datë 21.01.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve “*Transportimi dhe shoqërimi i të burgosurve*”, ku në kreun III të tij “*Detyrat e përgjegjësit të grupit të shoqërimit*”, pika 3.1/8 përcaktohet se “*Merr në dorëzim sendet personale sipas procesverbalit*”.

**Për sa i përket ankesës të të dënuarit A. V.**, në përgjigjen që kemi marrë nga IEVP Malësi e Madhe thuhet se, materialet e ardhura nga IEVP Fier janë shoqëruar nga vetë i dënuari. Kontrolli fizik është kryer në prani të të dënuarit A. V. dhe për materialet e ndaluara është mbajtur procesverbal i nënshkruar prej tij.

Referuar procesverbalit të datës 03.12.2021, të mbajtur në IEVP Malësi e Madhe, sendet që i janë ndalur të mbajë në regjim i dënuari A. V. janë: petrogaz, tabelë pikturë, tenxhere, tas inoksi, lugë metalike, kapëse rrobash, vinovil, paketë ... (nuk kuptohet), qumësht në karton dhe tas i vogël me hi.

Në vijim të hetimit administrativ të kësaj ankese, jemi interesuar pranë IEVP Fier ku kemi kërkuar të informohemi nëse ndodheshin të magazinuara sende të të dënuarit A. V. dhe të na dërgohej fotokopje e procesverbalit të mbajtur për sendet personale që i janë dorëzuar punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve që e kanë shoqëruar këtë të burgosur për në IEVP Malësi e Madhe.

Në përgjigjet që kemi marrë nga IEVP Fier me shkresat Nr.493/1 Prot., datë 08.02.2022 dhe Nr.1238/1 Prot., datë 15.03.2022 jemi vënë në dijeni se për shkak të pamundësisë ditën e transferimit të tij, sendet personale nuk janë marrë nga forcat e policisë së DPB-së, pasi kishte mbingarkesë në automjetin e transportit. Këto sende ndodhen të magazinuara në IEVP Fier, në pritje për t'u tërhequr në një moment të dytë nga Forcat Operacionale (DAP) dhe dërguar të dënuarit A. V. Gjithashtu, në përgjigje informohemi se edhe vetë i dënuari mund të autorizojë një prej familjarëve për të marrë sendet tek IEVP-ja. Ndër të tjera, IEVP Fier shprehet se në rastet e transferimit të të dënuarve nga një institucion në tjetrin, sendet dhe mjetet personale merren nga i dënuari duke mos mbajtur procesverbal dorëzimi, pasi i dënuari është vetë i pranishëm në kontrollin dhe transportin e sendeve personale. IEVP Fier na ka vënë në dispozicion fotokopje të procesverbalit të datës 06.11.2021 të sendeve personale të të dënuarit A. V., të cilat nuk janë transportuar nga grupi i shoqërimit të DPBurgjeve ditën e transferimit dhe janë mbajtur në magazinë për arsye sipërpërmendur.

Për të përfunduar hetimin administrativ lidhur me ankesën e të dënuarit A. V., kemi kërkuar me shkresa të përsëritura<sup>4</sup> pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, ndër të tjera, të informohemi nëse janë marrë masa për t'i dërguar të dënuarit A. V. në IEVP Malësi e Madhe, sendet personale që nuk janë marrë nga forcat e policisë së DPB-së në IEVP Fier, për arsye të mbingarkesës në automjetin e transportit. Po ashtu, kemi kërkuar të na dërgohej fotokopje e procesverbalit të mbajtur nga punonjësit e grupit të shoqërimit të DPBurgjeve për marrjen e sendeve personale të të dënuarit A. V. në IEVP Fier dhe të procesverbalit të dorëzimit të sendeve personale në IEVP Malësi e Madhe.

---

<sup>4</sup> Shkresat: Nr.K2/A49-5 Prot., datë 02.02.2022; K2/49-10 Prot., datë 01.04.2022; Nr. K2/A49-14 Prot., datë 14.06.2022; K2/A49-15 Prot., datë 13.10.2022; K2/A49-17 Prot., datë 22.11.2022.

Në përgjigjen që kemi marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve me shkresën Nr.13943/1 Prot., datë 09.12.2022, informohemi vetëm mbi qëndrimin e këtij institucioni për ankesën për transferim të padrejtë që ka paraqitur i dënuari A. V. dhe mundësinë e akomodimit në një IEVP tjetër. Por, nuk na është sqaruar dhe dërguar dokumentacioni përkatës të administruar që lidhet me marrjen në dorëzim dhe të dorëzimit të sendeve personale të të burgosurit gjatë transportit nga IEVP në një tjetër.

**Ndërsa, për sa i përket ankesës së familjarit të të burgosurit A. L.,** pas interesimit tonë, bashkëlidhur përgjigjeve që kemi marrë nga IEVP Durrës<sup>5</sup> dhe IEVP Malësi e Madhe<sup>6</sup>, na është dërguar fotokopje e procesverbaleve si më poshtë vijon:

- Procesverbal i datës 03.09.2021 i mbajtur në IEVP Durrës “*Mbi kontrollin e materialeve të tepërta të të dënuarit A. L. ardhur nga Burgu i Fushë-Krujës*”;
- Procesverbal i datës 04.10.2021 “*mbi kontrollin e materialeve të të dënuarit A. L. të marra në magazinë dhe të kaluara në regjim*”, i mbajtur në IEVP Durrës;
- Procesverbal i datës 29.10.2021 “*për konstatimin e materialeve që nuk mund të futen në regjimin e brendshëm*” (në këtë datë i dënuari A. L. ndodhej në IEVP Durrës);
- Procesverbal i datës 29.10.2021 “*mbi kontrollin dhe futjen në R.B të materialeve të të dënuarit A. L.*”, i mbajtur në IEVP Durrës;
- Procesverbal i datës 07.12.2021 “*mbi marrjen e materialeve të të burgosurit A. L., të cilat nuk hyjnë në regjimin e brendshëm, nga ana e familjarëve*”, i mbajtur në IEVP Durrës.

Konstatojmë se, dokumentacioni që na është vënë në dispozicion i përket vitit 2021 dhe jo datës kur i dënuari A. L. është transferuar nga IEVP Durrës në IEVP

---

<sup>5</sup> Shkresa Nr.158/1 Prot., datë 16.05.2022.

<sup>6</sup> Shkresat: Nr. 2177/1 Prot., datë 20.05.2022 dhe Nr.2177/5 Prot., datë 05.12.2022.

Malësi e Madhe, konkretisht në datën 18.04.2022, sipas urdhrorit të transferimit Nr.4387/1, datë 13.04.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

Pas analizimit të informacionit dhe dokumentacionit shoqërues për të dy rastet objekt të hetimit administrativ rezulton se, nuk janë zbatuar kërkesat ligjore për mbajtjen e procesverbalit të marrjes në dorëzim dhe dorëzimit të sendeve personale të të dënuarve A. V. dhe A. L., pas transferimit të tyre nga një IEVP në tjetrën. Në rastet e transferimit do të duhet të mbahet procesverbal nga punonjësit e IEVP-së që dorëzojnë sendet e të burgosurit, punonjësit shoqërues të tyre dhe punonjësit e IEVP-së ku transferohet i burgosuri. Gjithashtu, do të duhet të mbahet procesverbal edhe për sendet që merr në dorëzim i burgosuri pas transferimit sipas kërkesave ligjore të parashikuara në aktet e përmendura më lart.

Po ashtu, moskryerja e këtyre veprimeve nuk çon në krijimin e një raporti besimi të shtetasve të burgosur me administratën e Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale.

Në rrethanat kur nuk respektohet kjo praktikë ligjore, pra duke mos u dokumentuar në mënyrë të saktë në procesverbale dorëzimi i sendeve (sasisë dhe llojit të tyre) të të burgosurve në rastet e transferimit, lë shteg për mundësi të abuzimit nga punonjësit e burgjeve. Nga ana tjetër mund të ngrihen pretendime jo të qenësishme nga të burgosurit për mos dorëzimin e tyre edhe nëse sendet janë dorëzuar efektivisht, fakt që nuk mund të provohet nga strukturat e administratës për shkak të mungesës së dokumentacionit përkatës. Gjithashtu, është me rëndësi të kuptohet se nuk mund të jenë të pranueshme pretendimet e IEVP Fier për dërgim të vonuar të sendeve personale apo marrje të tyre nga familjarët. IEVP duhet të organizojë punën që të mos çënojë të drejtat e të dënuarve, e nëse nuk i realizon ato për arsye teknike t'i realizojë në momentin më të parë. Këto sende janë minimale, por të rëndësishme për mirëqënien e të dënuarve.

Për sa më lart, bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: "*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut*" si dhe në

mbështetje të nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*" i ndryshuar ku përcaktohet se: "*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*".

### **REKOMANDOJMË:**

- Marrjen e masave të nevojshme për mbajtjen e procesverbalit të marrjes në dorëzim dhe të dorëzimit të sendeve personale të të burgosurit në rastet e transferimit të tij nga një IEVP në tjetrën.
- Organizimin e punës për të siguruar dërgimin e sendeve personale të të dënuarve së bashku me të në rastet e transferimit.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nenin 22 të Ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*" i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**KOMISIONERI**

**Ermonela Ruspi**